

Fjala e Paqes



*Qe, Virgjëra
do të mbesë shtatzënë
e do të lindë një djalë,
të cilit do t'ia ngjeshin
emrin Emanuel -
që do të thotë:
Hyji me ne!
Mt. 1, 23*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 4 (147) Viti XXI Tetor - Dhjetor 2019**

EDITORIAL

20 vite më parë, me rastin e 25-vjetorit të shugurimit tim meshtarak, lindi revista dioqezane “Fjala e Paqes”, një mjet komunikimi përmes të cilit në çdo kënd të Arqidioqezës sonë do të arrinin lajmet e jetës dioqezane, të dobishme për bashkëndarjen më të tjerët, por sidomos të ideve dhe të linjave baritore.

Gjatë këtyre 20 viteve kanë parë dritën e botimit 147 numra të Fjalës së Paqes dhe materiali i mbledhur dhe i botuar është një tjetër mjet që tregon historinë e Arqidioqezës sonë, të pasur me ngjarje që, vit pas viti, kanë kontribuar për zhvillimin e këtij realiteti kishtar, i cili rilindi pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri.

Por, siç dihet, kohët ndryshojnë dhe bota është në zhvillim të vazhdueshëm edhe përsa u përket mjeteve të komunikimit. Shtypi në letër edhe pse është një mjet i vlefshëm dhe i qëndrueshëm, gjithsesi është duke kaluar një periudhë krize në kohën e sotme të globalizimit dhe kur ka marrë hovë të madh informacioni elektronik.

Nga ana tjetër, të gjithë, tashmë, nga më i madhi deri te më i vogli, kemi mjete të tilla që, nëse përdoren siç duhet, lehtësojnë komunikimin dhe, pse jo, edhe përhapjen e Lajmit të Mirë të Ungjillit dhe lajmet e tjera të mira që kanë të bëjnë me Kishën.

Për këtë arsye, duke filluar prej vitit 2020 informacioni dioqezan do të kalojë nëpërmjet një organi të vetëm shtypi zyrtar dhe kjo është revista “Kumbona e Dielës” e botuat së pari herë në vitin 1938, e ku, përveç ngjarjeve kulturore, tipike për këtë revistë, aty do të gjenden edhe informacionet që deri tani ishin ekskluzive të revistës “Fjala e paqes”.

Por edhe këtu do të ketë një risi: kopjet e shtypura do të jenë aq sa do të jenë edhe kërkesat që do të mbërrijnë në Redaksi. Nga ana tjetër, përhapja e Revistës dioqezane do të bëhet edhe përmes kanaleve elektronike me kërkesë të të interesuarve dhe, siç ndodh edhe tani, ajo do të hidhet edhe në Sitin e Arqidioqezës, aty ku ndodhen edhe numrat e vjetër të këtyre dy revistave.

Uroj që kjo gjë të mos ulë vëmendjen ndaj jetës dhe veprimtarive të Kishës sonë vendore: është detyrë e Ipeshkvit dhe e meshtarëve ajo që t'i informojnë besimtarët, por është detyrë edhe e çdo besimtari ajo që ai vetë të informohet dhe të marrë pjesë në jetën kishtarë, në mënyrë të përgjegjshme.

Nga ana ime dhe e Redaksisë jemi të gatshëm që t'i mirëpresim sugjerimet tuaja, të cilat mund t'i dërgoni me qëllim që ta përmirësojmë këtë shërbim kaq të rëndësishëm.

Ju bekoj me gjithë zemër.

† Angelo Massafra O.F.M.
Arqipeshkëv

Solidaritët me rastin e termetit



Imzot Angelo Massafra O.F.M.

Arqipeshkëv Mitropolit Shkodër-Pult

President i Caritas-it Shqiptar, dërgon kete mesazh, nga Athina

ku gjendet për një takim Europian :

“Do të dëshiroja t'Ju përshëndesja me fjalët e Presidentit tonë Sh.së Tij Mons. Angelo Massafra:

“Nga Athina, ku këto ditë po marr pjesë në Asamblenë e Ipeshkvinjve të Europës mbi temën e shpëtimit të gjithësisë, marr pjesë me dhimbje në gjendjen e krijuar pas fatkeqësisë natyrore që ka goditur tokën tonë, duke shkaktuar viktima e dëme të konsiderueshme materiale.

Jam pranë familjeve që kanë humbur të afërmit e tyre dhe kanë pësuar dëme materiale. Do jenë të gjithë të pranishëm në lutjet e mia dhe në mirësinë e Zotit të mëshirshëm; por në të njëjtën kohë, si President i Caritas-it Shqiptar, garantoj përfshirjen aktive të kësaj strukture në lehtësimin e shqetësimeve dhe nevojave të tyre. Zoti pastë mëshirë dhe e ndaloftë këtë plagë që po godet në mënyrë të vazhdueshme tokën tonë dhe uroj që këto rrethana do të na ushqejnë dhe nxisin të gjithëve drejt ndihmës reciproke dhe solidaritetit vëllazëror, të cilat, në momente si këto, duhet të na gjejnë më të bashkuar se kurrë”.



PËRSHUMOT KRISHTLINDJEN 2019 DHE VITIN E RI 2020



«Gëzo o qiell, galdo o tokë, sepse Zoti po e ngushllon popullin e vet" (Is 49, 13)

Të dashur besimtarë,

Mesazhi që këtë vit dëshiroj t'ju drejtoj me rastin e Krishtlindjes dhe të Vitit të Ri kushtëzohet prej ngjarjeve që kanë ndodhur në Shqipëri, në veçanti prej tërmetit të tmerrshëm që shkaktoi jo pak viktime e la pas plagë e brishtësi për shoqërinë shqiptare. Megjithatë, edhe pse ka zbehur gëzimin e këtyre festave, nuk ka aq fuqi sa ta vrasë shpresën tonë. Le të mikpresim nxitjen e Palit apostull që të mos jemi të trishtuar si ata që nuk kanë shpresë (krh. 1Sel 4, 13).

Si bashkësi katolike e dioqezës, jemi duke reflektuar gjatë këtij viti mbi rëndësinë që ka të jetuarit në Krishtin, të shoqëruar nga slogani Paulin: “Që në Emër të Jezusit të perkulet çdo gju i atyre që janë në qiell, në tokë e në nëntokë” (Fil 2, 10).

Të jetosh në Krishtin do të thotë të kesh “po ato ndjenja që ishin në Krishtin Jezus” (Fil 2, 5), domethënë: vetëdije për marrëdhënien birnore që na lidh me Hyjin Atin tonë; vlerësim i vetes si krijesa dhe si rrjedhojë në marrëdhënie me të ngjashmit tanë dhe me krejt krijimin.

Të gjithë i shohim gjestet e solidaritetit, që populli ynë ka bërë gjatë tërmetit të fundit, krahas solidaritetit që kemi marrë prej shumë shteteve të tjera.

Por njëkohësisht të gjithë i shohim edhe gjërat negative që po ndodhin në vendin tonë. Megjithatë, të fortë prej vetëdijes se jemi në duar të Zotit që nuk na braktis dhe të bindur për

aftësinë tonë për të bërë mirë, nuk mund të humbim shpresën dhe të bëjmë disa reflektime të rastit. Kush e di nëse katastrofa natyrore që na ka goditur një muaj më përpara nuk mund të shërbejë si “shkundje”, me qëllim që Shqipëria jonë t'i hapet një kohe ku interesi për të mirën e përbashkët të bëhet më i madh se ai për të mirën private, ku strukturat që janë krijuar për mbrojtjen e jetës të funksionojnë në mënyrë efikase dhe ku formimi i punonjësve, i teknikëve dhe i vullnetarëve në raste emergjencash të merret seriozisht?

Kush e di nëse gjithë kjo rrëmujë shoqërore që jemi duke përjetuar në këtë moment nuk favorizon formimin dhe specializimin në artin e politikës të personave pa interesa personale, por me një dashuri të madhe për Atdheun, të gatshëm për t'u vënë në drejtimin e vendit?

Kush e di nëse largimi nga vendi i shumë të rinjve dhe i shumë familjeje nuk është një rast për ata që qëndrojnë që ta rishikojnë gjendjen aktuale të vendit dhe ndërgjegjet t'i hapen një bashkëpunimi faktik mes qytetarëve dhe shtetit për të përmirësuar realitetin ekzistues, duke ndalur këtë fluks që shprehimisht është duke varfëruar tokën tonë prej atyre energjive të reja dhe jetësore për të cilat ajo ka nevojë?

Hyji mund ta bëjë një gjë të tillë, por jo pa përgjigjen pozitive të bijve të vet. Qysh prej momentit të parë kur njeriu u shfaq në tokë, siç na thotë Shkrimi i shenjtë, Hyji ia besoi njeriut detyrën e mbarështuesit të saj (krh. Zan 1, 28); një detyrë prej të cilës askush nuk mund të ndihet i lënë jashtë apo i përjashtuar. Aq më pak, ne të krishterët!

Nuk ekziston asnjë kategori personash që nuk mund të japë kontributin e vet: secili për sa i takon dhe sipas mundësive të veta mund dhe duhet të ndihet bashkëpërgjegjës në mbarëvajtjen e vendit; si fillim duhet të ndryshohen të gjithë ato qëndrime që e pengojnë shtetit që të bëjë detyrën e vet: para së gjithash inati ndaj institucioneve, pastaj mendësia mafioze e shit-blerjes së favoreve, pasi një favor që më bëhet mua është një akt padrejtësie që i bëhet dikujt tjetër: me fjalë të tjera, është ajo që quhet “korrupsion”. Për këtë arsye, i ftoj të gjithë të krishterët që ta vlerësojnë këtë angazhim si një akt të vërtetë kulti kushtuar Hyjit.

Urimi im nuk është thjesht një urim në kuptimin klasik të fjalës, por ai dëshiron të jetë edhe një nxitje e fortë drejtuar çdo personi vullnetmirë, me qëllim që Krishtlindja të sjellë ndryshime të vërteta dhe thelbësore: përndryshe, do të ishte një rast i humbur, një mashtrim që i bëjmë vetes që, të verbuar prej dritave dhe ngjyrave të festës, nuk do të jemi të aftë të shohim praninë e Hyjit që na do, që do të mirën tonë dhe që na fton për ta bërë të mirën.

Jezu Krishti, Hyji-me-ne, e bekoftë këtë tokë, i dhëntë asaj paqe e qetësi; i shëroftë të sëmurët tanë dhe zemrat e plagosura prej tragjedisë; pastë mëshirë për të vdekurit; qoftë udhëheqësi i mendjeve tona, zjarri që ndez zemrat tona, veçanërisht të atyre të rinjve që, të pashpresë, po kërkojnë diku tjetër realizimin e tyre; në mënyrë që të dashuruar më shumë me vendin tonë të qëndrojnë këtu me qëllim që Shqipëria jonë e bukur të rindërtohet me bashkëpunimin dhe dashurinë e të gjithëve

Ju uroj Përshumëvjet Krishtlindjen 2019 dhe Gëzuar Vitin e Ri 2020 katolikeve, ortodoksëve, të krishterëve dhe njerëzve vullnetmirë.

† Angelo Massafra OFM
Arqipeshkev



FILLIMI I MUAJIT MISIONAR NË SHKODËR

HOMELI E MBAJTUR NGA IMZOT ANGELO MASSAFRA - 1 TETOR 2019

Vëllezër e motra, reflektimi mbi përmasën misionare të Pagëzimit tonë (“Të pagëzuar dhe të dërguar” – kjo është tema që Ati i shenjtë ka zgjedhur për këtë rast) nuk mund të kufizohet brenda pak minutash në një homeli, ashtu si nuk mund të shterohen në një letër të gjitha tekstet e përgatitura për këtë muaj të jashtëzakonshëm misionar. Bëhet fjalë për gatishmërinë e zemrës sonë për të hyrë brenda vetes sonë, për të marrë seriozisht në konsideratë hirin e pagëzimit tonë, për të kuptuar se si të qenit i pagëzuar na hap ndaj përmasës misionare, për të vendosur që ta jetojmë këtë përmasë misionare në jetën tonë të zakonshme të krishterë dhe, ndoshta edhe në atë të jashtëzakonshme. Shpesh jemi mësuar të quajmë “misionarë”, dhe t’i konsiderojmë si të tillë, vetëm ata që lënë shtëpinë dhe tokën e tyre për të shkuar në vendet ku Krishti nuk njihet ende dhe ku mesazhi i tij i shpëtimit nuk ka mbërritur akoma. Me siguri, këta burra dhe gra kanë marrë prej Zotit një thirrje specifike për mision; por përmasa misionare është e lidhur ngushtë me Pagëzimin dhe, pra, i përket me të drejtë çdo të krishteri. Pastaj, kjo e drejtë, është edhe një detyrë; ashtu siç thotë Shën Pali: “I mjeri unë nëse nuk e predikoj Ungjillin!” (1Kor 9,16).

Për të krishterin, angazhimi misionar i ka rrënjët e veta në misionin e Trinisë së Shenjtë dhe, në veçanti, në atë të Jezusit, dërguar prej Atit për shpëtimin e botës. Të krishterët nuk “bëjnë mision”, por “marrin pjesë”, secili sipas karizmave të veta, në misionin e vetëm të Birit të Hyjit, falë impulsit dhe veprimit të Shpirtit Shenjt, që gjithmonë vepron në jetën e Kishës.

Papa thotë: «Jeta jonë është, në Krishtin, një mision! Ne vetë jemi mision, sepse jemi dashuri e Hyjit të komunikuar, jemi shenjtëri e Hyjit krijuar në përngjasim të tij. Pra, misioni është shenjtërimi ynë dhe i botës mbarë, qysh prej krijimit (krh. Ef 1,3-6). Përmasa misionare e pagëzimit tonë përkthehet kështu në dëshmi shenjtërie, që i jep jetë dhe bukuri botës» (Papa Françesku, Fjalimi drejtuar Drejtorëve Kombëtarë të Veprave Misionare Papnore, 1 qershor 2018).

Pra, duke mos mundur që të paraqes këtu, në pak minuta, krejt teologjinë e misionit, po kufizohem të paraqes disa pika për reflektim marrë prej letrave të Liturgjisë që jemi duke kremtuar.

Veprimi profetik i Zakarisë synon që të ngushëllojë dhe të ngulitë një fuqi të re te populli i vet pas periudhës së mërgimit në Babiloni. Në vazhdimësi me traditën profetike, Zakaria e di mirë se cila është thirrja e popullit të Izraelit në mes të të gjithë popujve të tjerë, por e di edhe se si pabesnikëria e popullit e ka çuar atë që të provojë mërgimin e hidhur, rast ky për të arritur në një vetëdije të re: vetë Hyji është bariu dhe udhëheqësi i popullit të vet. Jo vetëm, por vetë Hyji do të hidhet në veprim, me qëllim që përgjatë historisë, por sidomos në fund të kohëve, “popuj dhe banorë të shumë qyteteve; banorët e një qyteti do të shkojnë tek ata të tjetrit, duke thënë: “Le të shkojmë menjëherë t’i përgjrohemi fytyrës së Zotit dhe të kërkojmë Zotin e ushtrive. Edhe unë do të shkoj” (Zak 8, 20-23).

Në Ungjill kemi dëgjuar se si Zoti Jezus i bashkon me veten e vet të

gjithë njerëzit që përgatisin kalimin e tij në qytetet dhe në fshatrat ku ai shkonte, duke marrë përsipër edhe rrezikun e mospranimit të tyre. Apostujt me pohimet e tyre tregojnë se ende nuk e kanë kuptuar domethënien e misionit të mëshirës së Birit të Hyjit, duke pohuar kështu një linjë mendimi tipike për Izraelitët e kohës, domethënë atë që ta konsideronin veten si zotërues absolutë të Hyjit. Por Hyji nuk mund të zotërohet, pasi ai vetë u dhurohet falas të gjithëve. Ka vetëm nevojë për dikënd që t’ia përgatisë rrugën.

Pra, misioni i Kishës është vetëm ai që të marrë pjesë në misionin e Birit të Hyjit, i cili është Bariu i vërtetë që i mbledh të gjithë popujt, i tërheq të gjithë tek vetja jo me fuqinë e madhështisë, por me forcën dhe fuqinë e kryqit. Jezusi, rrugës për Jerusalem, ku do të përmbushte misionin e vet, u ka kumtuar të vetëve për tre herë radhazi mënyrën me të cilën do të realizohej ky shpëtim, por ata nuk e kanë kuptuar, sepse është e vështirë që të kuptosh se si mund të shpëtohet në një mënyrë tjetër prej mënyrës se si bota e kupton shpëtimin.

Shpesh edhe Kisha përgjatë shekujve ka pasur të njëjtën vështirësi, duke menduar se mund ta bëjë më mirë misionin e vet nëse, krahas përmasës shpirtërore që e karakterizon atë, të shtonte edhe atë të pushtetit kohor. Por historia i jep edhe një herë të drejtë Jezusit: vetëm kryqi mund ta sjellë shpëtimin. Kryqi ka forcën dhe pushtetin që ta shkatërrojë mashtruesin më të madh të njerëzve që, pasi ka dështuar në tundimin e Jezusit në shkretëtirë, kthehet vazhdimisht për t’i tunduar besimtarët në Krishtin me të njëjtat iluzione të pushtetit dhe të zotërimit.

Kurse Jezusi na pajis me disa ilaçe shumë të efektshme në ushtrimin e misionit: atë të varfërisë, kur të tijve u urdhëron që të mos marrin asgjë me vete kur udhëtojnë, sepse zotërimi ngadalëson misionin; atë të vëllazërisë, kur sugjeron që të qëndrojnë në një shtëpi, e cila bëhet pikë takimi në mision, sepse marrëdhëniet vëllazërore janë mjeti më i mirë i përhapjes së mesazhit; atë të vendosmërisë, kur urdhëron që të mos përsëriten askënd gjatë rrugës dhe që të shkundin pluhurin nën këmbë kur nuk pranohen prej të tjerëve, sepse misioni nuk pranon ngadalësime.

Është e nevojshme që t’i kushtojmë një vëmendje të madhe njeriut, siç bën Jezusi, për të parë se si Hyji e ka dashur atë dhe se si e ka bërë objekt të privilegjuar të mesazhit të shpëtimit të Jezusit. Ta duam Hyjin deri në atë pikë sa marrja pjesë në misionin e Birit të na hapë domosdoshmërisht ndaj një dashurie të madhe për njerëzimin, derisa kjo e fundit të arrihet prej vetë dashurisë së Atit.

Kështu, Kisha lidhet më shumë me botën, taman nëpërmjet një vëmendje më të madhe ndaj njeriut, për gëzimet dhe shpresat e tij, për trishtimet dhe ankthet e tij, sidomos nëse ai është i varfër, i dobët, i braktisur, i largët. Kjo vëmendje ndaj njeriut, pastaj, nuk mund të mos jetë edhe burim thirrjesh të reja, jo vetëm për jetën e krishterë, por edhe për jetën e shuguruar dhe meshtarinë ministeriale.

Ashtu siç është e nevojshme edhe që të kemi një dashuri të madhe për krijimin, i cili nuk mund të përjashtohet prej angazhimit misionar të besimtarit në Jezusin, sepse edhe ai – siç thotë Shën Pali – pret së bashku me ne, që shëlbimi i bërë prej Jezusit të arrijë plotësinë e vet të plotë (krh. Rom 8,22).

Po i përfundoj këto mendime të mia ashtu siç kam filluar, duke nxitur njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë me qëllim që të bëjmë të mundur që kremtimi i sotëm të ndikojë fortësisht te ndërgjegjet tona dhe të shkaktojë një impuls të fortë misionar.

Uroj që, duke u mbledhur sërish më 26 tetor në Vlorë, të zbulojmë në fytyrat tona gëzimin se kemi rigjetur në ne bukurinë e vetëdijes se jemi pjesëmarrës të misionit të Jezusit, me forcën e Shpirtit Shenjt, me qëllim që krejt bota ta njohë, ta adhurojë dhe ta dojë Hyjin. Atij ndera dhe fuqia në shekuj të shekujve.

Amen.



“ISLAMI DHE KRISHTERIMI MES HISTORISË DHE PERSPEKTIVAVE” TRYEZË E RRUMBULLAKËT E ORGANIZUAR NGA PROVINCA FRANÇESKANE “ZOJA NUNCIATË”



Ne si françeskan përkujtojmë këtë vit 800 vjetorin e takimit historik të Shën Françeskut të Asizit me Sulltanin e Egjiptit dhe në këtë kuadër kemi organizuar edhe në Shqipëri një tryezë të rrumbullakët, ku së pari kemi përkujtuar 800 vjetorin e takimit të Shën Françeskut të Asizit me Sulltanin e Egjiptit. Në rradhë të dytë kemi përkujtuar edhe atë që Papa Gjon Pali i II ka bërë më 27 tetor 1986 në Asizi, duke realizuar ëndrrën e madhe ku kishte ftuar përfaqësuesit e besimeve të ndryshme të botës, që t'i lartësohej “Një Zoti të vetëm”, prej zemrave të ndryshme dhe prej gjuhëve të ndryshme, një këngë të vetme paqeje. Dhe së treti kemi përkujtuar 5 vjetorin e vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri.

Organizimi në fjalë u mbajt ditën e shtunë më 23 nëntor 2019 në Tiranë pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në orën 10:30 në “Aula Magna”.

Ishin të ftuar të gjithë krerët e besimeve fetare në Shqipëri personalisht, ose në mungesë të tyre një përfaqësues i tyre. Përveç këtyre ishin të ftuar klerik të ndryshëm, dhe me ftesa ishin të ftuar edhe persona të ndryshëm në këtë tryezë të rrumbullakët.

Ky takim filloi në orën 10:30 dhe u hap nga moderatori fra Gazmend Tinaj, i cili tregoi shkurtimisht përmbajtjen e këtij takimi si dhe falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre. Në këtë takim ishin edhe disa nga autoritetet e larta fetare, diplomatike dhe shtetërore në Shqipëri: Imzot George Frendo, Arqipeshkëv i Arqipeshkvisë Metropolitane Tiranë-Durrës dhe kryetar i Konferencës Ipeshkvnore në Shqipëri; Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Arqipeshkvisë Shkodër-Pult; Imzot Charles John Brown, Nunci Apostolik në Shqipëri; provinciali i Provincës Françeskane Shqiptare, fra Aurel Gjerka; znj. Loreta Aliko, kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet; znj. Christina Vasak Ambasadorja e Republikës Franceze në Shqipëri; Hirësia e Tij Asti, episkopi i Bylisit; Dervish Sali Peti, klerik bektashian që përfaqësonte Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj; sheh Hysen Hormova, kryetar i Tarikatit Halveti, sheh Bujar Harasani kryetar i Tarikatit; Kadri, Sheh Ali Pazari i Tarikatit Halveti i teqes së Tiranës, Pastor Altin Hysi i Kishës

Ungjillore dhe sheh Hasan Selimi, përfaqësues i Tarikatit Sadi. Menjëherë pas fra Gazmendit vazhdoi kori, i cili nën udhëheqjen e fra Luigi Aluisi OFM ekzekutoi këngën “Lavdet e të Tejetlartit Hyj” të Imzot Marko Frisinës. Më pas vijoi fra Aurel Gjerka me përshëndetjen, i cili u ndoq nga Imzot George Frendo, ku ky i fundit e vuri theksin tek bashkëpunimi ndërfetar, i cili duhet të njihet si “harmoni fetare” dhe jo “tolerancë fetare”, siç e cilësojnë shumë persona sot.

Pastaj vazhdoi me kumtesën e tij don Valentino Cottini, prift dioqezan i Dioqezës së Veronës (Itali), i cili është docent i rregullt pranë Pontificio Istituto di Studi Arabi e d'Islamistica. Pas tij vijoi myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, i cili u ndjek nga z. Dhimitër Qosja, pedagog në Fakultetin e Shkencave Humane në Kolegjin Universitar “Logos”, departamenti i “Teologjisë dhe Kulturës”.

Në fund të të gjitha kumtesave të pranishmëve iu dha mundësia t'i drejtonin pyetje anëtarëve të panelit.

Pas pyetjeve u shpërndanë të gjithë të pranishmëve lutja e thjeshtë që u lut nga të gjithë, dhe më pas kori ekzekutoi këngën “Kënga e Krijesave” të shën Françeskut, e cila shënoi edhe mbylljen e këtij takimi. Në fund dhe një herë fra Gazmendi falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe ata që janë angazhuar në mundësimin e këtij takimi, sidomos fra Landi Jaku, i cili është delegati i Provincës Françeskane Shqiptare për Ekumenizmin dhe dialogun ndërfetar.

Në fund një moment lutjeje së bashku për t'i kërkuar Zotit që të na ruajë në Paqë në kombin tonë dhe që Zoti t'u dhurojë Paqën të gjithë popujve që janë në luftë ose në konflikte ndëretnike. Kjo lutje quhet lutja e thjeshtë dhe vijon;

O Zot, më bëj mjet të Paqës Sate:

ku ka urrejtje – unë ta sjell dashurinë,

ku ka fyerje – unë ta sjell faljen,

ku ka ngatërresa – unë ta sjell pajtimin,

ku ka mashtrim – unë ta sjell të vërtetën,

ku ka dyshim – unë ta sjellë besimin,

ku ka dëshpërim – unë ta sjell shpresën,

ku ka terr – unë ta sjell dritën,

ku ka pikëllim – unë ta sjell gëzimin.

O Zot, bëj që mos të kujdesohem aq

që të jem i ngushëlluar – sa të ngushëlloj,

që të më kuptojnë – sa t'i kuptoj unë të tjerët,

që të më duan – sa të dua.

Sepse: kush dhuron vetveten – e fiton vetveten;

kush harron vetveten – e gjen vetveten;

kush fal – do t'i falet;

kush i vdes vetvetes – lind për jetën e amshuar.

Në fillim do të ketë një këngë që është e nxjerrë nga një lutje e shën Françeskut me titull: “I Tejetlarti Hyji im”, dhe në fund përsëri një këngë që është e nxjerrë nga një lutje tjetër e shën Françeskut me titull “Kënga e Krijesave”

Fra Landi Jaku OFM

EMERGJENCA E TËRMETIT NDËRHYRJET E CARITAS-IT SHQIPTAR

Pas tërmetit 26 nëntorit 2019, edhe Kisha Katolike u solidarizua me të prekurit nga kjo fatkeqësi. Lutje si dhe ndihma materiale dhe financiare buruan nga bashkësitë e krishtera për vëllezërit dhe motrat e zonave të prekura. Një ndër shumë ndërhyrje, po jua paraqesim në vijim.

Tiranë 01 Dhjetor 2019
Prot.nr. 394/2019

Fort të Nderuarave Shkëlqesi
të Dioqezave Shqiptare
Shkëlqesisë së Tij Mons. Charles John Brown
Nunci Apostolik

Objekti: Emergjencia Tërmeti – ndërhyrjet e Caritas-it Shqiptar
Shkëlqesi të Nderuara,
Deri më tani janë 51 viktimat e tërmetit të fortë me magnitudë 6.5 e që të martën me datë 26 Nëntor goditi Shqipërinë, mbi 2000 janë të plagosurit e me mijëra janë të zhvendosurit. Pas këtyre ditëve të para po fillohet të vihet në dukje impakti apo ndikimi që kanë patur në territoret ku ka dëmtuar qindra ndërtesa dhe mijëra shtëpi, duke



lënë mijëra njerëz pa shtëpi. Sipas një vlerësimi paraprak nga qeveria, më shumë se 10,000 njerëz janë regjistruar pa shtëpi, por nga analiza që po bëjmë së bashku me operatorët e Caritas-it tonë,



Caritas-et tuaja Dioqezane dhe anëtarët e rrjetit Caritas Internationalis që kanë ardhur për të na ndihmuar, por dyshojmë që ky numër të jetë edhe më i lartë. Po vazhdojmë verifikime të mëtejshme dhe numri sigurisht që do të vazhdojë të rritet. Dioqeza Tiranë -Durrës ka qenë Dioqeza më e prekur por edhe në Dioqezat e afërta të shumta janë personat e zhvendosura. Prandaj, këtë emergjencë duam ta jetojmë si një periudhë bashkimi dhe bashkëpërgjegjësie: kundër tundimit të lehtë të izolimit egoist dhe heqjes dorë nga përkushtimi kundrejt të tjerëve, ku ofrohet bamirësia ungjillore, si të marrim mbi shpatullat tona ngarkesat e

njëri-tjetrit dhe të ecin së bashku. Këtë emergjencë ne duam ta jetojmë si një kohë shprese: kundër dëshpërimit dhe nënshtrimit pasiv e që rievokon shpresën e krishterë si një stimul për të menaxhuar vetë personalisht të ardhmen duke besuar te Hyu.

Caritas-i Shqiptar ka qenë aktiv në zonë që nga orët e para së bashku me mbështetjen e të gjithë Caritas-eve Tuaja Dioqezane dhe rrjetit të famullive dhe misioneve të pranishme. Me mijëra janë personat që kemi parë e vizituar deri më tani, falë punës së shumë vullnetarëve, motrave, etërve e laikëve por dhe operatorëve. Së bashku kemi mikpritur njerëzit, kemi përgatitur dhe shpërndarë ushqime dhe ndihma, kemi dëgjuar ngjarjet dhe vuajtjet e tyre, e kemi luajtur me fëmijët.

Gjatë këtyre ditëve po mundohemi të përcaktojmë veprimet përgjatë muajve të parë dhe po mundohemi të forcojmë koordinimin mes të gjithëve ne. Tashmë kemi zhvilluar një takim të parë koordinues me të gjithë drejtorët e Caritas të Dioqezave dhe një tjetër me Klerin e Dioqezës së Tiranës dhe Lezhës. Në këto javë të para ne do të vazhdojmë të takohemi dhe të informohemi reciprokisht çdo javë.

Principi bazë e kësaj pune që na pret, ashtu siç është shprehur edhe Presidenti ynë i Konferencës Ipeshkvnore, bazohet në 4 shtylla:

- Ndhmë duke nisur nga më të varfërit e më të prekurit nga tërmeti
- Përdorimi i rrjetit Caritas dhe rrjetit të famullive e misioneve për të zhvilluar iniciativat.
- Transparencë e komunikim maksimal në administrimin e ndihmave e ndërhyrjeve si dhe të proceseve.

Kordinimi i të gjitha iniciativave e ndërhyrjeve që do të ndërmerren për të shmangur mbivendosjet, konfuzionin në ndihma dhe nismat personale

Gjatë javëve në vijim do të vazhdojmë punën e ndihmës së parë, asistencës, afërsisë e dëshmisë së dashurisë së Hyut kundrejt më nevojtarëve duke u munduar të na drejtojmë drejt objektivave të rindërtimit: duke shmangur rrezikun e rrudhjes së tyre vetëm në nevojat imediate (për t'u rikthyer, apo riparatur një shtëpi), si dhe duke evidentuar plotësinë e vizionit të krishterë që priret të rindërtojë njeriun dhe komunitetin.

Angazhimi që na pret ka marrë drejtimin drejt asaj rruge të vështirë të rindërtimit: kundër egoizmit, fitimit, padurimit dhe ngadalësisë, ku vigjilenca e krishterë evidentohet si një gatishmëri për sakrificë dhe sëmbim kritik kundrejt vonesave të pajustificuara.

Do të dëshiroja t'Ju përshëndesja me fjalët e Presidentit tonë Sh.së Tij Mons. Angelo Massafra:

“Nga Athina, ku këto ditë po marr pjesë në Asamblenë e Ipeshkvinjve të Europës mbi temën e shpëtimit të gjithësisë, marr pjesë me dhimbje në gjendjen e krijuar pas fatkeqësisë natyrore që ka goditur tokën tonë, duke shkaktuar viktima e dëme të konsiderueshme materiale.

Jam pranë familjeve që kanë humbur të afërmit e tyre dhe kanë pësuar dëme materiale. Do jenë të gjithë të pranishëm në lutjet e mia dhe në mirësinë e Zotit të mëshirshëm; por në të njëjtën kohë, si President i Caritas Shqiptar, garantoj përfshirjen aktive të kësaj strukture në lehtësimin e shqetësimeve dhe nevojave të tyre.

Zoti pastë mëshirë dhe e ndaloftë këtë plagë që po godet në mënyrë të vazhdueshme tokën tonë dhe uroj që këto rrethana do të na ushqejnë dhe nxisin të gjithëve drejt ndihmës reciproke dhe solidaritetit vëllazëror, të cilat, në momente si këto, duhet të na gjejnë më të bashkuar se kurrë”.

Me çdo bekim

*P. Antonio Leuci - Rcj
Drejtore i Caritas-t Shqiptar*

*+ Angelo Massafra O.F.M.
Arqipeshkëv Mitropolit i Shkodrës
President i Caritas-it Shqiptar*

KOMISIONI PËR BARITOREN SHOQËRORE

Ka pasur si temë: “Bashkësia vendore si model mikpritjeje dhe integrimi në Evropë” takimi i Komisionit për Baritoren Shoqërore, Seksioni i Migracionit, i Konferencave Ipeshkvnore të Evropës, mbajtur në Athinë, me datat 26-28 nëntor 2019, ku ka marrë pjesë edhe Imzot Angelo Massafra në cilësinë e anëtarit, si edhe të përfaqësuesit të Kishës sonë në Shqipëri. Një reflektim i thelluar që, siç thotë vetë slogani i takimit, ka pasur si synim të shqyrtojë se si sot Bashkësitë tona të krishtera mund të paraqesin një model konkret mikpritjeje dhe integrimi.

Shpesh tema e migrantëve është trajtuar më shumë si problematikë, sesa si pasuri për Bashkësitë tona: mungesa e formimit dhe e informimit çon, shpesh, në mbyllje. Dëshmitë e këtyre tre ditëve kanë bërë që të dalë në pah se si në shumë bashkësi të krishtera, sidomos në Evropën e Veriut, lëvizjet migratore u kanë dhënë jetë veprimtarive kishtarë.

Pjesëmarrësit në takim kanë parë se si në Athinë mikpritën emigrantët: me angazhimin e shtetit, të Kishës ortodokse, të Kishës katolike (latine dhe lindore) dhe të shoqatave; janë mikpritur prej Ipeshkvit dhe besimtarëve të ritit armen, duke kremtuar Meshën e shenjtë në Ritin Armen dhe duke qëndruar me ta për darkë; dhe në fund kanë vizituar Komunitetin Papa Gjoni XXIII dhe Lagjen e “Të padukshmëve”, ku jetojnë të varfrit, shumë thjesht dhe me shumë dinjitet.

Edhe bindja e gabuar se të gjithë ata që emigrojnë janë islamikë shpesh bën që të mos mikpritën, prej një frike të pajustificuar. Për këtë arsye nevojitet që të informohemi më mirë; për ta bërë këtë gjë është e nevojshme, para së gjithash, që të jemi mikpritës dhe të hyjmë në marrëdhënie me secilin prej tyre. Prej këtij lloji lind një njohje më e madhe dhe mundësia jo vetëm për t’u ofruar një shërbim të përshtatshëm baritor të krishterëve emigrantë, por edhe mundësia për të qenë ungjillëzues, sipas mandatit pagëzimor.

Kisha katolike është e hapur dhe e gatshme për këtë dinamikë mikpritjeje dhe integrimi, e fortë prej Ungjillit të Krishtit dhe e shtyrë prej Shën Gjoni Palit II dhe shkrimeve të tij, si edhe prej fjalëve inkurajuese të Papa Françeskut për të ecuar në këtë drejtim.

Duke pasur parasysh ndryshimet e shumta, edhe Kisha katolike në Shqipëri e jeton këtë vëmendje dhe përkujdesje ndaj emigrantëve që vijnë në Shqipëri, përmes Caritas-it Shqiptar dhe gatishmërisë së Fshatit të Paqes në Shkodër, në marrëveshje me Shtetin Shqiptar. Por edhe në drejtimin e kundërt, Kisha katolike në Shqipëri përpigjet që t’u ofrojë një shërbim baritor bijve të saj emigrantë, duke shkuar aty ku ata jetojnë dhe duke u ofruar, përsa është e mundur, një shërbim minimal baritor.

Imzot Massafra ka qëndruar tri ditë më shumë që t’i takojë shqiptarët, dhe mik i fretërve kapuçinë të Athinës, ka kremtuar tri Meshë të shenjta: në Korint, në Ion dhe në Athinë. Besimtarët dhe Motrat e Nënë Terezës i kanë kërkuar Arqipeshkvit një angazhim më të madh për besimtarët në Greqi, sidomos për rrëfimet. I shtyrë prej kësaj kërkesë, Imzot Massafra, ka dërguar për një javë, pak para Krishtlindjes, Dom Charbel Bachour-in për të rrëfyer besimtarët katolikë që gjenden atje.

Kronisti

SEKSIONI I MIGRACIONIT I KONFERENCAVE IPESHKVNORE TË EVROPËS

Athinë, 26-28 nëntor 2019



VIZITA BARITORE E IMZOT ANGELO MASSAFRA

Më 6-7-8 gusht 2019 Ipeshkvi Imzot Angelo Massafra vizitoi fshatrat e Pultit: Kir, Xhan, Pog-Megull e Prekal. Në çdo fshat kremtoi Meshën e Shenjtë dhe u dha sakramentin e Krezmimit 20 të rinjve e të rejave në dy fshatra.

Takimi me popull u shënua nga thjeshtësia dhe zemërgjerësia e tij.

Por Ipeshkvi, si babë e bari, nuk heshti përballë së vërtetës të të qenurit të krishterë: të jetuarit në praninë e Trinisë së Shenjtë, shenjë e përkatësisë në të cilën, është shenja e Kryqit. I kërkoi popullit të krijojë marrëdhënie pozitive mes burrit e gruas dhe fëmijëve, duke iu referuar tri fjalëve të Papa Françeskut: FALEMINDERIT - MË FAL - ME LEJE. Në fund të çdo kremtimi i ftoi ngrohtësisht prindërit që të mos i martojnë vajzat në moshë shumë të re dhe pa i njohur mirë djemtë me të cilët i martojnë vajzat, sepse janë të shumta ndarjet dhe divorcet.

Përballoi problemin e kultivimit të drogës duke thënë se tundimi është i madh për të pasur shumë lekë në duar, por sa e sa më shumë duhen për të liruar ndonjërin nga burgu, sado i bukur të jetë, si ai i Reçit.

U kërkoi prindërve të kenë kujdes celularët që fëmijet tashmë i kanë nëpër duar, sepse nëpërmjet tyre, duke keqpërdorur internetin, shumë të këqija po hyjnë në zemrat e të rinjve dhe dhe po ua marrin mendjen atyre. Në fund dhe pas fotove të ritit, me thjeshtësi Ipeshkvi bëri fotografi me fëmijët, të rinjtë dhe me familjet. Gjatë itinerarit tonë një befasi tjetër na priti në Prekal: duhej të kalonim lumin Kir për të arritur në një familje e për t'i dhënë sakramentin e kungimit e të krezmimit një djali të ri të paralizuar. Nikolla është një 18 vjeçar muskujt e të cilit, qysh në fëmijëri, pak nga pak kanë filluar të atrofizohen derisa ka arritur paralizën e plotë.


Për të na e bërë më të lehtë dhe të thjeshtë kalimin e lumit Kir, dy djem të fshatit na përgatitën rrugën me gurë të mëdhenj, në mënyrë që të mund të kalonim përtej lumit pa u lagur. Por gëzimi i Nikollës dhe mahnitja e tij duke e parë veten të rrethuar nga dashuria dhe kujdesi ia bëri të lehtë çdo vështirësi. Faleminderit Monsinjon për vizitën e bërë kësaj pjese të Kishës. Janë pak por të fortë në besimin dhe fenë e tyre.

Faleminderit për kohën e kaluar së bashku me mua, në të cilën bëra edhe rolin e shoferit dhe pata mundësinë e kënaqësinë të bashkëndaj me ju jetën e kësaj grigje të vogël që nuk ka tjetër alternativë përveç neve që të kujdesemi për jetën e saj.

*Motër Sandra Bortolotto
Përgjegjësjë e Baritores*



n'Pult ...



VIZITA BARITORE E IMZOT ANGELO MASSAFRA NË BARDHAJ

Më 24 tetor 2019, Arqipeshkvi ynë, Imzot Angelo Massafra ka ardhur në Bashkësinë tonë të Bardhajve për t'u dhënë krezmimin 63 të rinjve, që kishin përfunduar kursin e përgatitjes dhe për të prezantuar zyrtarisht famullitarin e ri, Dom Emilio Valente-n, i cili ka bërë shpalljen e fesë dhe premtimin e dëgjësës përpara Ipeshkvit dhe bashkësisë.

Pak ditë më pas, më 10 nëntor, ka filluar vizitën baritore në famullinë tonë: Bardhaj dhe Bardhanjor, me kremtimin e Meshës në fillim në Bardhanjor, me Dom Emilio-n dhe pastaj në Bardhaj ku ishte i pranishëm edhe Dom Rolando-ja, epror i bashkësisë. Në fund të Meshës, gjatë bisedës me besimtarët, Ipeshkvi u ka kujtuar të gjithëve, por sidomos të rriturve, pikat e rëndësishme që duhen pasur parasysh për të mos dëshiruar një pasurim të lehtë dhe të menjëhershëm, si edhe për të mos kultivuar dhe për të mos përdorur drogë, e cila aq shumë po përdoret prej të rinjve; po ashtu, ka kujtuar rreziqet e përdorimit të celularit pa kontroll dhe të lundrimit në sitet pornografike, si edhe martesat e vajzave të mitura, e cila është një plagë që vazhdon e rrjedh gjak. Pastaj ka takuar grupin e ministrantëve dhe më fund meshtarët orioninë, motrat dhe Ipeshkvi kanë drekuar së bashku në një klimë vëllazërore.

Ditët në vazhdim, deri më 16 nëntor, Imzot Massafra ka dëshiruar t'i

takojë të gjitha forcat e gjalla të famullisë: grupin e Legjonit të Marisë, me ftesën që lutjes t'i bashkëngjesin veprat e bamirësisë; të rinjtë e oratorit, katekistët dhe më pas grupet e katekizmit: të rinjtë e krezimit që janë më shumë se 40 vetë, dhe fëmijët në përgatitje të Kungimit të Parë, të cilët i ka ftuar ngrohtësisht jo vetëm për të marrë pjesë në katekizëm, por sidomos në Meshën e së dielës.

Një vizitë të veçantë ka bërë të martën, më 12 nëntor, në kopshtin e Motrave Oblate të Zojës Ruzare, që bashkëpunojnë në famulli në mënyrë shumë aktive dhe mbarështojnë këtë kopsht prej 24 vitesh. 80 fëmijët e kopshtit, nën drejtimin e edukatoreve të tyre, kishin përgatitur një shfaqje shumë të bukur me këngë, valle e poezi. Ipeshkvi ka falënderuar Motrat, edukatoret dhe nënat e shumta të pranishme aty, për punën që bëjnë në edukimin me durim e dashuri të këtyre fëmijëve në mënyrë njerëzore dhe të krishterë dhe e ka mbyllur takimin duke i bekuar të gjithë.

Të premten, më 15 nëntor, dhe të shtunën, më 16 nëntor, i shoqëruar nga Dom Emilio-ja dhe nga bashkëpunëtori Donald Vulaj Imzot Massafra ka vizituar disa familje të varfra dhe disa të tjera që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, duke kërkuar prej nesh një vëmendje të veçantë për këto kategori personash.

Dom Rolando Reda, Orionin



VIZITA BARITORE E IMZOT ANGELO MASSAFRA NË FAMULLINË “ZOJA E NGJITUR NË QIELL” - GRUDË E RE

Vizita baritore e Mons. Angelo Massafres në Famullinë e Grudës së Re filloi me datën 17 nëntor. Monsinjori kishte sjellur me vete edhe Relikët e Martirëve. Ai u prit nga përgjegjësi baritor i famullisë, Atë Gjergj Ndreka. Në fillim të Meshës së Shenjtë Atë, Gjergji i drejtoi fjalët e mirëseardhjes dhe në emër të famullisë e përshëndeti dhe e falenderoi për viziten që po bën në këtë famulli. Ndër të tjera Atë Gjergji i prezantoi Ipeshkëvit gjendjen e famullisë, ku vihet në pah largimi i të rinjve por edhe i familjeve të ndryshme në emigracion. Një aspekt tjetër që nënvizohet nga Atë Gjergji është edhe varfëria e madhe në të cilën gjinden shumë banorë. Një problem tjetër që iu komunikua Ipeshkëvit ishte edhe përdorimi i drogave nga fëmijët dhe të rritët. Pas prezantimit, Monsinjori me shumë keqardhje, pohon që është në dijeni të këtyre problemeve.

Në fund të meshës së shenjte Monsinjori - siç zakonisht bën në vizitat baritore - dha për besimarët katër këshilla shumë të forta dhe konkrete.

Këshilla e parë ju drejtohet prindërve, që të kenë kujdes për fëmijët e tyre sidomos nga përdorimi i telefonit në mënyrë të pakontrolluar.

Këshilla e dytë ishte përsëri për prindërit, që të mos martojnë vajzat në moshë të re dhe pa qenë të përgatitura si nga ana mendore ashtu edhe shpirtërore, dhe që vajzat të jenë të lira në zgjedhjen për jetën e tyre.

Në këshillen e tretë, Ipeshkvi ftoi të gjithë katolikët që të mos kërkojnë të pasurohen në mënyra të jashtëligjshme, duke koltivuar drogë dhe gjëra të tilla. Kutivimi i drogës dhe përfitimi i pasurisë nga shit-blerja e drogës është e mallkuar.

Këshilla e katërt dhe e fundit, ishte për të gjithë ata që nuk shikojnë një shpresë në Shqipëri dhe që duan të largohen nga ky vend. Monsinjori fton të gjithë që të qëndrojnë në Shqipëri dhe të punojnë dhe të ndërtojnë këtu të ardhmen tonë dhe të fëmijëve tanë, pavarësisht se kjo kërkon sakrificë dhe shumë mundim.

Pasi Monsinjori dha këto këshilla, bekoi bashkësinë e mbledhur në Kishë me Relikët e Martirëve dhe pastaj ftoi të gjithë besimtarët që të puthin relikën dhe të marrim si shembull dëshminë që Martirët tanë na kanë lënë. Pas Meshës së Shenjtë, Monsinjori takoi grupin e familjeve që është themeluar në këtë famulli duke i ftuar që të jenë të qëndrueshëm në premtimet e tyre dhe të lindin fëmijë sipas mundësive që kanë për t'i mbajtur ata. Pati pyetje të ndryshme nga të pranishmit, dhe Monsinjori u përgjigj me shumë qartësi dhe kënaqësi.

Kjo ditë përfundoi me drekën tek etërit Vinçencian.

Dita e dytë e vizitës baritore e Ipeshkëvit filloi me viziten tek kopshti i fëmijëve tek Motrat e Dashurisë Hyjnore. Fëmijët kishin përgatitur disa këngë dhe recitime për Monsinjin. Ata u gëzuan shumë për praninë e Tij

në mesin e tyre. Pas takimit me fëmijët e kopshtit, Ipeshvi takoi nxënësit e shkollës së Grudës së Re të cilët erdhën bashkë me disa mësues tek oratori “Shën Vinçenc de Paoli”. Në takimin me nxënësit, Monsinjori i ftoi ata që të mësojnë shumë dhe të edukohen sepse duke studiuar njeriu bëhet i ditur dhe mund të ndërtojë një të ardhme më me dinjitet.

Vizita vazhdoi pastaj me kremtimin e Meshës së Shenjtë në kapelen e varrezave të fshatit Grudë e Re dhe pas meshës i bekoi. Pas bekimit të varrezave Monsinjori takon bashkësinë e Motrave të Dashurisë Hynore që janë në famullinë tonë.

Në ditën e tretë të vizitës baritore, Monsinjori e zhvillon duke vizituar disa familje të famullisë, edhe se kërkesat për të vizituar familjet ishin të shumta, por ne arritëm të vizitonim disa që kishin më shumë nevojë dhe me probleme të veçanta.

Dita e katërt e vizitës baritore zhvillohet tek Qendra Ditore për fëmijët e varfër, në fshatin Vinotekë. Edhe këtu Motër Mrika (Vinçenciane) bashkë me bashkëpunëtorin e saj Valentinën kishin përgatitur një program të vogël për të mikpritur Ipeshkvin dhe për ta falenderuar për praninë e tij. Pas takimit me fëmijët, Ipeshkvi qëndron tek bashkësia Vinçenciane dhe pas drekës përsëri vizita vazhdon në Vinotekë, sepse në kishën kushtuar Shën Vinçenc de Paolit bëmë Adhurimin Eukaristik për thirrje të reja për Kishen, dhe pastaj Monsinjori takoi shoqaten e “Medaljes Mrekullibërëse” që është themeluar në këtë bashkësi nga Meshtarët Vinçencianë.

Viziten baritore, Ipeshkvi do ta mbyllte me Meshën e Shenjtë, me 24 nëntor, por për arsye shëndetësore, Mesha e Shentë u celebrua me 22 dhjetor. Edhe në Kishen e Vinotekës Ipeshkvi u prit nga Atë Gjergj Ndreka, i cili në fillim të Meshës së Shenjtë i uroi mirëseardhjen dhe gëzimin e besimtarëve për prezencën e tij në mesin e tyre. Pastaj iu prezantua situata dhe gjendja e fshatit dhe të besimtarëve që janë të ngjashme me famullinë e Grudës së Re. Në fund të Meshës së Shenjtë, Ipeshkvi dha edhe në Kishën e Vinotekës këshillat që kishte dhënë edhe në Grudë, duke shtuar ftesën për të mos shkuar te fallxhorët ose tek magjistarët, si tha Papa Françesku me 4 dhjetor 2019: “Ju lutem: magjia nuk është e krishterë! Këto gjëra që bëhen për të njohur të ardhmen apo njohur shumë gjëra apo për të ndryshuar situatat e jetës, nuk janë të krishtera”.

Arqipeshkvi, duke na bekuar me Kryqin e relikëve të Martirëve tanë dhe duke puthur besimtarët Relikët, përfundoi vizitën baritore në Famullinë e “ZOJA E NGJITUR NË QIELL” Grudë e Re.

Atë Gjergj Ndreka, Vinçencian



VIZITA BARITORE E IMZOT ANGELO MASSAFRA NË FAMULLINË E “SHËN TEREZËS SË KALKUTËS”, HOT I RI

Më 20 nëntor 2019 Mons. Angelo Massafra filloi vizitën baritore në famullinë tonë. E filloi me më të vegjlit e kësaj famullie tek kopshti i motrave në Hot të Ri. Monsinjori bashkëndau disa momente me ta, ku kishin përgatitur një surprizë të vogël për të. Pastaj Monsinjori bashkëndau edhe drekën në shtëpinë e motrave dhe pasdite u takua me Legjionin e Marisë, këshillin e Kishës dhe me disa prindër, duke bashkëndarë me ta disa momente lutjeje dhe reflektimi, por edhe gjërat që ata i shqetësojnë, më pas vazhdoi vizitën me motrat e bashkësisë së Hotit të Ri.

Me 20 dhjetor, Mons. Angelo Massafra vazhdoi sërish me vizitën baritore, ku pasdite takoi të gjithë fëmijët e katekizmit me katekistët e tyre duke bashkëndarë me ta mbi jetën e të Lumëve Martirë Shqiptarë, e në fund ndau edhe disa imazhe të tyre për të gjithë fëmijët e famullisë.

Vizitën baritore në famullinë e “Shën Terezës së Kalkutës”, Hot i Ri, e mbylli me 22 dhjetor në të dielën e katërt të Ardhjes. Ishte gëzim i madh për ne që të kishim mes nesh Bariun tonë, duke na kujtuar kështu që JEZUS do të thotë Zoti shëlbën e Emanuel- Zoti me ne, dhe do të jetë deri në mbarimin e botës. Në fund të Kremtimit të Eukaristisë, pati mundësinë të bashkëndajë disa momente me besimtarët, e pastaj së bashku me Etërit Vinçencianë, të cilët shërbejnë në këtë famulli, qëndruan tek motrat për drekë. Pasdite takoi të rinjtë e famullisë, duke i porositur që nuk mjafton vetëm të njohim Zotin, por duhet ta takojmë Atë.

Në emër të famullitarit, Atë Arjan Ndoj CM, të motrave të bashkësisë së Hotit të Ri dhe të gjithë besimtarëve që jetojnë në këtë fshat, i falenderohemi përzemërsisht Mons. Angelo Massafra për kujdesin dhe dashurinë që tregon për grigjën që i është besuar!

I premtojmë lutjet tona të përvujtura!

Ate Arjan Ndoj, Vinçencian



KRISHTLINDJE NË MUZE

“Krishtlindje në Muze” është aktiviteti që Muzeu Dioqezan organizoi me datat 28 dhjetor 2019 dhe 4 janar 2020 për fëmijët e moshës 10-14 vjeç, ku morën pjesë gjithsej 34 fëmijë, nga shkolla të ndryshme të qytetit.

Disa prej objektivave të këtij aktiviteti ishin që pjesëmarrësit të mësonin duke u kënaqur dhe të kënaqeshin duke mësuar, të bënin përvojën që gjërat fitohen me punë dhe studim dhe nuk jepen falas apo për mëshirë, të njihnin më mirë veten dhe të tjerët, ndërsa bashkëvepronin mes tyre, të reflektonin mbi përjetimin vetjak të Krishtlindjes dhe të merrnin informacione mbi Krishtlindjen, si edhe ta përjetonin muzeun si vend që ndërsa u flet për të kaluarën, i ndihmon ata për të ndërtuar të tashmen dhe të ardhmen e tyre.

Pas lojërave të prezantimit, fëmijët janë ndarë në dy grupe dhe kanë zhvilluar lojëra të ndryshme, si p.sh. piloti, ku fëmijët kanë ndërtuar avionë letrash dhe ka fituar skuadra avionët e të cilës kanë flutuar më larg; poliglotti, ku fëmijët kanë grupuar fjalët sipas gjuhëve përkatëse (anglisht, italisht, gjermanisht) dhe ka fituar ajo skuadër që i ka grupuar fjalët më saktë dhe më shpejt; shkrimtari, ku fëmijët kanë hartuar një tekst që flet për Krishtlindjen dhe ku ka fituar skuadra që e ka hartuar më shpejt atë; dëgjuesi, ku fëmijët kanë parë një video të shkurtër mbi Krishtlindjen dhe ka fituar ajo skuadër që mbante më shumë fjalë mend prej videos; dhe në fund, pllakëvënësi, ku fëmijët kanë plotësuar dy puzzle të vogla. Në fund të çdo loje, secila skuadër ka marrë nga një informacion (p.sh. ku është ai vjen era bagëti ose përdoret për të na kujtuar diçka apo dikënd), që do t'i ndihmonte ata për të gjetur dy objektet misterioze, që ndodheshin dikund në muze. Në fund, me të gjitha informacionet e nevojshme në dorë dhe plot entuziazëm, dy grupet kanë shkuar në muze dhe kanë kërkuar objektin që u përgjigjej informacioneve që kishin fituar me anë të lojërave dhe ato ishin: grazhdi (betlemi) dhe kumbona, simbole të Krishtlindjes.

Aktiviteti është mbyllur me një vizitë të të gjithë pjesëmarrësve, fëmijë dhe prindër, në muze, vizitë kjo shumë ndërvepruese, pasi fëmijët patën mundësi jo vetëm të bënin pyetje, por edhe të jepnin përgjigje kur ciceroni i muzeut u drejtonte ndonjë pyetje të rastit. Pak para daljes prej muzeut, shumë prej fëmijëve kanë lënë përshtypjet e tyre në Librin e muzeut dhe u kanë shprehur organizatorëve emocionet dhe ndjenjat që kanë përjetuar gjatë gjithë këtij aktiviteti.

Libri “Zoti u flet fëmijëve të vet” është një tjetër kujtim-dhuratë që fëmijët morën me vete prej aktivitetit “Krishtlindje në muze”.

Loreta Tomaj



DRISHTI NGA LASHTËSIA NË MESJETË

Me datë 16 Dhjetor 2019, në mjediset e Muzeut Dioqezan - Shkodër, Komisioni Drejtësi dhe Paqe i Shqipërisë, në kuadër të forcimit të rolit të kishës Katolike në Shqipëri dhe të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, organizoi konferencën shkencore me temë Drishti nga Lashtësia në Mesjetë.

Në këtë aktivitet ishin të ftuar personalitete të fushave të ndryshme, studiues, historiane, përfaqësues të institucioneve kulturore të qytetit, përfaqësues fetarë të besimeve të ndryshme por edhe njerëz të thjeshtë të interesuar në këtë temë.

Relator i aktivitetit ishte Dr. Paulin Pushimaj, arkeolog.

Pas një prezantimi të shkurtë të Dr. Pushimaj nga moderatori i aktivitetit, z. Luigj Mila, sekretar i përgjithshëm i Komisionit Drejtësi dhe Paqe, u vijua me aktivitetin.

Pozicioni strategjik i kalasë së Drishtit, e vendosur në kodrat e Drishtit dhe e kufizuar nga lumi Kir, e bënte atë një qëndër shumë të rëndësishme tregtare, kulturore dhe fetare gjatë periudhës së Mesjetës. Kjo veçanti e kalasë së Drishtit nuk u la pas edhe nga prezantimi i Dr. Pushimaj i cili e filloi fjalën e tij duke falenderuar të pranishmit dhe veçanërisht Imzot Angelo Massafren për vënien në dispozicion të ambienteve të Muzeut Dioqezan për zhvillimin e kësaj konference.

Me pas ai vijoi me prezantimin e punës së tij në majen e Muzhiles, e cila ndodhet në kodren përballë kalasë së Drishtit. Pikërisht në këtë kodër ndodhet edhe kisha e Shen Mërisë, objekt i punës së Dr. Pushimaj. Ai prezantoi para të pranishmeve gërmimet e zhvilluara nga ai, në të njëjtën kohë duke shpjeguar edhe rëndësinë shpirtërore, kulturore, artistike dhe arkeologjike të këtij objekti, të shoqëruar edhe nga disa foto të shkrepura gjatë kryerjes së punimeve.

E veçanta e punimeve në këtë sit arkeologjik të rëndësishëm, është gjetja e një varreze masive në qëndër të kishës, ku janë zbuluar një sasi e madhe eshtrash njerëzore të përziera edhe me eshtra kafshësh. Pikërisht kjo e bën më të veçantë këtë vendgërmim. Për momentin nuk dihet arsyeja e vërtetë e ekzistencës së një “varreze” të tillë, por mendimi i Dr. Pushimaj është shpërthimi i një epidemie dhe për të izoluar përhapjen e saj u vendos varrimi i të infektuarve në këtë “varrezë”. Gjithsesi, për momentin mbetet vetëm një hipotezë dhe për një rezultat më të qartë për ekzistencën e një vendi të tillë do të duhen gërmime dhe studime të mëtejshme. Edhe kjo konferencë u zhvillua pikërisht për të kuptuar rëndësinë e këtij siti arkeologjik dhe për të parë mundësitë e vazhdimit të mëtejshëm të punimeve.

Majk Mila



IMZOT ANGELO MASSAFRA NË GREQI ME KATOLIKËT SHQIPTARË

Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvi i Shkodër-Pult mori pjesë në takim mbi emigracionin në Athinë me datat 26-29 nëntor 2019. Pasi qëndroi dy ditë për te kremtuar Meshën me Emigrantët katolikë.

Koha e Ardhjes këtë vit filloi ndryshe nga vitet e tjera ku shënoi ardhjen e Bariut tonë fort të dashur, Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvi Shkoder-Pult.

Për bashkësitë tona në Greqi (Athinë, Korinth, Inoi) ishin dy ditë të jetuara me intensitet në praninë e Imzot Angelos, të mbushura me bekime, hire dhe gëzime, gjithashtu edhe mallëngjim.

Duke përjetuar këtë vizitë ishte me të vërtetë një shembull i Bariut të Mirë që shkon në kërkim të deleve të humbura dhe me gatishmerinë e tij të menjëhershme për t'ju dhënë Sakramentin e Rrefimit. Shumë besimtar presin me kohë për të marrë këtë Sakrament në gjuhën amtare dhe kanë bërë kërkesën Arqipeshkvit që të dërgojë meshtarët për rrëfime. Imzot Massafra premtoi se para Krishlindjes, do të dërgonte një meshtar.

Në këtë menyë, duke i udhëhequr në pjesëmarrjen e plotë në Meshën e Shenjtë, ku Bari i mire i ushqen me fjalën e tij dhe më pas me Korpën dhe Gjakun e Krishtit.

Imzot Massafra gjatë predikimit të tij, foli për deshminë e Martirëve tanë dhe nxiti besimtarët të kërkojnë ndërmjetësinë e tyre. Gjithashtu theksoi rëndësinë e vlerave familjare si lutja e përbashkët në familje.

Ka mbyllur homelinë me tre porositë (tri fjalë) e Atit të Shenjtë:

1. Me Leje: të dialogojmë me njeri-tjetrin.

2. Faleminderit: të jemi mirënjohës ndaj njëri-tjetrit.

3. Më Fal: të mësojmë të mposhtim krenarinë tonë duke kërkuar falje kur gabojmë.

Gjithashtu ftoi besimtarët të luten për viktimat e tërmetit, që ndodhi në Shqipëri.

Pas Meshës, besimtarët patën mundësi të bashkëndajnë momente vëllazërore së bashku. Një falënderim i veçantë i shkon Atë Gabriele Righetto dhe Etërve Françeskanë Kapuçinë dhe Motrave të Nënë Terezës, për angazhimin e tyre në shërbim të emigrantëve dhe si shoferë për levizjet e Imzot Massafres.

*Eliona Demaj
Katekiste*



PËRKUJTIMIT LITURGJIK I TË LUMËVE MARTIRË TË SHQIPËRISË

Shkodër, më 5 nëntor 201 (Imzot Angelo Massafra O.F.M.)

Koha liturgjike që jemi duke jetuar është një dhuratë hiri prej Zotit që, ndërsa na bën të shohim natyrën kalimtare të kësaj jete, na hap ndaj horizonteve të lavdisë dhe frymëmarrjeve të amshimit. Nëse nga njëra anë festa e të gjithë Shenjtëve dhe kujtimi i të dashurve tanë të vdekur na shtynë të mendojmë për qiellin, nga ana tjetër ndihemi të ngushëlluar që jeta jonë në këtë tokë nuk është e kotë, por plot me vlera, në atë masë që e jetojmë atë plotësisht të orientuar kah Zoti që na ka krijuar, që në Krishtin na shpëton dhe, me Shpirtin Shenjt, na shenjtëron në shëmbëlltyrë të Tij që është “me të vërtetë i shenjtë dhe burim i çdo shenjtërie” (Lutja II eukaristike).

Kështu sot: ndërsa kujtojmë figurat e shenjtërisë së zakonshme, e megjithatë aq të veçantë në forcën e Martirizimit të tyre, të Imzot Prennushit me Shokë, nuk mund të kufizohemi që t'u atribuojmë atyre vetëm një nderim të jashtëm. Në fakt, siç thotë Shën Bernardi: “Çfarë u duhen atyre nderimet e kësaj toke kur, sipas premtimit të Birit, Ati qiellor i nderon?... Shenjtërit nuk kanë nevojë për nderimet tona dhe asgjë nuk u vlen atyre kulti ynë”.

Kujtimi i tyre na nxit që t'i shohim jo vetëm si ndërmjetësuesit tanë, por sidomos si modele jete të krishterë që duhen imituar. Shenjtëria e tyre është para së gjithash një shenjtëri e zakonshme, që shfaqet në koherencën e jetës së tyre me atë që kanë besuar e shpresuar; një shenjtëri e jetuar secili në gjendjen e vet të jetës si ipeshkvij, meshtarë, të kushtuar dhe laikë.

Le të citojmë Shën Françeskun e Salesit, i cili shkruan: “Devocioni duhet të praktikohet në mënyrë të ndryshme nga fisniku, nga zanatliu, nga shtëpiaku, nga princi, nga vejusha, nga gruaja e martuar dhe nga vajza. Kjo nuk mjafton; praktikës së devocionit duhet t'i shtohen forcat, angazhimet dhe detyrimet e çdo personi. ...A do të ishte mirë nëse ipeshkvi do të jetonte në vetminë që jetojnë murgjit certozinë? Dhe nëse gratë e martuara nuk do të donin të kishin asgjë si fretërit kapuçinë? Nëse zanatliu do ta kalonte gjithë ditën në kishë si rregulltarët dhe do t'u shërbente të gjithë njerëzve si do ta bënte detyrën e tij ipeshkvi? A nuk do të ishte qesharak, i çrregulluar dhe i papranueshëm ky devocion? Ky gabim bëhet shumë shpesh. ...Devocioni nuk shkatërron asgjë kur është i sinqertë, madje përsos gjithçka dhe, kur i kundërvihet angazhimeve të ndonjërit, pa dyshim që është i rremë”.

Vëllezër e motra, duke i jetuar me koherencë angazhimet tona të përditshme me lehtësi mund ta arrijmë majën e shenjtërisë.

Në vend të dytë, shenjtëria e tyre është shfaqur edhe për shkak të një elementi tjetër që nuk duhet harruar: dashuria. Me dashuri ata kanë vepruar në dobi të atdheut duke u angazhuar në vetën e parë. Për dashuri ata kanë punuar pa u lodhur për të kumtuar Ungjillin. Siç thotë Shën Pali “të gjitha këto i bëj për dashuri të Ungjillit” (1Kor 9,23), kështu kanë bërë edhe Martirët tanë, pa përjashtim dhe secili sipas gjendjes së vet të jetës. Bashkëndarje e jetës me atë që jetonte në malet më të lashta, prani ngushëlluese pranë familjeje më në nevojë, gatishmëri për të plotësuar nevojat e më të varfërve: të gjitha raste të privileguara për kumtimin e Ungjillit. Po çfarë mund të themi për shkollat? Edhe ato ishin raste për të luftuar padijen dhe për të njohur Zotin.

Për dashuri të Krishtit dhe të Kishës ata kanë flijuar jetën e tyre, duke falur me dashuri ata që po i vrisnin. Po, falja. Një art i vështirë për t'u praktikuar, por tepër ungjillor që na bën të ngjashëm me Hyjin i cili “mund të falë mëkatet” (Mk 2,7). Por Jezusi na mëson se edhe për ne është e mundur kur te lutja “Ati ynë” vë një kusht të domosdoshëm për të marrë faljen e Hyjit: të falim edhe ne atë që na ka bërë keq.

Dhe këto janë vetëm aspektet e përgjithshme që u përkasin të gjithë atyre. Por kur zbresim më në thellësi të jetës së secilit prej Martirëve tanë zbulojmë një jetë shembullore që nuk mund të na lërë indiferentë, por që, madje, duhet të na nxisë edhe më shumë për të imituar virtytet e tyre. Dhe nuk flasim vetëm për virtytet teologale... por edhe për ato virtute njerëzore që mund t'i kenë të gjithë. Po listoj disa prej tyre.

Syhapur. Për ta parë realitetin dhe për të menduar se çfarë mund të bëjmë për ta përmirësuar atë. Asnjëri prej nesh nuk duhet të ndihet i përjashtuar prej dëgjësës së urdhrit të Krijesit që ta kemi përzemër

realitetin e krijuar dhe që ta ruajmë atë. Një rojtar vigjëlön, është i vëmendshëm, dallon pozitiven dhe negativen e gjërave, merr një pozicion dhe nuk tërhiqet nëse ndryshimi i tyre kërkon mund e lodhje.

Angazhim shoqëror. Vjen menjëherë pas syve të hapur. Martirët tanë nuk kanë qëndruar të mbyllur brenda kishave të tyre, por e kanë jetuar botën dhe kohën e tyre si protagonistë, duke bërë histori, duke u bërë zëri i të varfërve pranë institucioneve të ndryshme.

Angazhim për nxitjen e shpresës. T'i shohësh në çastet e fundit të jetës së tyre duke inkurajuar veten dhe shokët e tyre të burgut dhe të martirizimit është një mësim i shkëlqyeshëm shprese. Siç na mëson Papa Françesku, askujt nuk duhet t'ia lejojmë që të na e vjedhë shpresën. Shpresa është ajo që na bën t'ia rifillojmë sërish çdo ditë, nuk na lë në vend pas gabimeve tona, shikon përpara për të zbuluar kuptimin e të tanishmes dhe ofron arsye për të ecur përpara. Edhe nëse jetohet si virtyt teologal, Shën Palin na mëson që ajo “nuk zhgënjën” (Rom 5,5).

Angazhim kulturor. Mos t'ju duket diçka dytësore, pasi forma e parë për të luftuar varfërinë e një populli është angazhimi për të rritur nivelin e tij kulturor. Është forma e parë e lirisë: në fakt, për të sunduar një popull mjafton ta mbash atë në padije. E dini mjaft mirë se sa shumë janë angazhuar martirët tanë në aspektin kulturor!

Angazhim politik. Shpesh ngatërrohet me përfshirjen në një parti të caktuar politike. Por kuptimi fillestar i termit “politikë” është “dashuri për qytetin”, për “gjërat publike”: krejt e kundërta e asaj që zakonisht bëhet kur personi mendon vetëm për veten e vet dhe jo për të mirën e përbashkët.

Vëllezër e motra, këto janë vetëm disa prej virtyteve njerëzore të Martirëve. Shumë të tjera mund t'i zbulojmë ndërsa lexojmë biografitë e tyre. Një emërues i përbashkët i lidh: bërja e të mirës dhe luftimi i të keqes. Pra, le t'i njohim martirët tanë. Le t'i lexojmë jetët e tyre dhe t'ua tregojmë ato të tjerëve. Le t'i marrim si shembuj jete.

Dhe ata, me ndërmjetësimin e tyre të përbashkët, marrshin prej Zotit hirin e shenjtërisë së zakonshme, atë që nuk shkëlqen me dritën e vet, por që pasqyron vetë shenjtërinë që është Hyji. Atij i qoftë ndera, fuqia e lavdia për të gjithë shekujt e shekujve. Amen.



“MIKPRITJA E NJË POPULLI QË KËRKON LIRI”

20-vjetori i angazhimit tonë ndaj refugjatëve nga Kosova-promovim libri

Tingujt dhe fjalët e këngës “Përmbi lumenj të Babilonit”, shkruar nga Atë Martin Gjoka dhe kënduar nga bas-baritoni Lukë Mllugja, i dhanë fillesë aktivitetit të promovimit të librit të sapobotuar “MIKPRITJA E NJË POPULLI QË KËRKON LIRI: 20-vjetori i angazhimit tonë ndaj refugjatëve nga Kosova”, i cili u zhvillua në sallën “Kardinal Mikel Koliqi”, pranë Famullisë “Shën Shtjefni” të Arqidioqezës Shkodër-Pult.

Pas projektimit të fotove të datës 13 gusht 1998, “Lutje për paqe në Kosovë”, e mori fjalën Imzot Dodë Gjergji, Ipeshkëv i Kishës në Kosovës, i cili plot përmallim falënderoi Kishën në Shqipëri për mikpritjen që i bëri popullit kosovar në njërën prej ditëve të tij më të vështira dhe me ngulm kërkoi që libri në fjalë sa më shpejt të promovohet edhe në Kosovë.

Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult, në ndërhyrjen e tij bëri një panoramë të shkurtër të viteve 1998-1999, si përsa i përket gjendjes së popullit kosovar prej reprezaljeve serbe, ashtu përsa i përket organizimit dhe angazhimit të Kishës katolike në Shqipëri në mikpritjen e këtij populli që kërkonte liri.

Ajo që habiti sallën në ndërhyrjen e bërë nga Mons. Segundo Tejado, nënsekretar i Dikasterit për shërbimin e zhvillimit njerëzor dhe atij tërësor, 20 vite më parë, drejtori i Caritas-it Shqiptar ishte gjuha në të cilën ai foli. Edhe pse prej shumë vitesh larg Shqipërisë, ai me një shqipe të pastër dhe mjaft mirë të kuptueshme pohoi se ajo që kishte përjetuar gjatë emergjencës kosovare, ia kishte ndryshuar jetën dhe se tani, në detyrën e re, po bënte atë që kishte bërë 20 vjet më parë me kosovarët: t'i ndihmonte njerëzit horizontalisht, domethënë në nevojat e tyre tokësore, dhe vertikalisht, domethënë në prirjen e tyre drejt hyjnore.

Kujtimet që solli Atë Flavio Cavallini, ish-Provencial i Fretëve Minorë në atë kohë, ishin jo vetëm prekëse, por edhe të shumta. Bashkëndau me të pranishmit ndjeshmërinë e tij personale dhe të Kishës në lidhje me emergjencën kosovare, angazhimin dhe bujarinë e të gjithëve, vështirësitë dhe mënyrat me të cilat ia kishin dalë mbanë për t'i tejkaluar ato, kontaktet e shumta që kishin krijuar dhe solidaritetin e madh që kishte përjetuar, bashkëpunimin dhe dashamirësinë me personat me të cilët kishte rënë në kontakt, habinë dhe mrekullimin që kishte përjetuar ndërsa çonte në shtëpitë e tyre të moshuarit kosovarë, të cilët ishin ndarë prej familjarëve të tyre.

Pas videos me foto që paraqiste një pjesë të këtij angazhimi kolosal, Zonja Bora Tarri bashkëndau me publikun përvojën e vet personale gjatë emergjencës kosovare dhe gjatë momenteve të korrigjimit të bocës së librit.

Para 20 vitesh Motër Arta Suli, Motër Pie Venerini, sapo ishte kthyer nga Italia kur Dom Antonio Sciarra i propozon që të shkojë në Kukës,

së bashku me një grup të rinjsh, për të ndihmuar familjet Kosovare që kishin filluar të vinin në Shqipëri. “Një ndër rastet më të veçanta që erdhi në Zadrimë – tregon ajo – ishte rasti i Lavdies. Ajo ishte një vajzë 11 vjeçe dhe ndërsa po vinte me familjen e saj në Shqipëri i kanë vrarë babain dhe nënën para syve të saj. Lavdia ka ardhur në Gjadër duke mbajtur me shumë xhelozë një gjë të fshehur nën triko... vetëm pas disa orësh Motrat kanë arritur t'ia heqin nga dora një këpucë, e cila ishte e lagur me gjakun e nënës së saj, e vetmja gjë që kishte mundur të merrte me vete”. Më pas, plot përmallim, ajo vazhdoi duke thënë: “Dom Antonio ka qenë i pari i cili është nisur për këtë mision pasi ai ishte një profet dhe sapo kishte një emergjencë ishte aty, sepse profetët janë aty ku është Zoti dhe ku gjendet një vëlla apo një motër që vuan. Uroj që të kemi akoma edhe sot profetë, që i njohin shenjat e kohës dhe u përgjigjen vëllezërve dhe motrave në nevojë”.

Ndërsa Motër Valbona Hajdari, Motër e Bijave të dashurise hyjnore, në dëshminë së saj shumë prekëse, sa bëri gjithë sallën të përloset, pohoi: “Ishte një kalvar i tmerrshëm vuajtjesh dhe pasi udhëtuar dy ditë në këmbë arritëm në Shqipëri, saktësisht në Krumë të Hasit ku fjetëm në shkollën e fshatit. Më pas, prej aty kemi ikur në Kukës dhe tre ditë më pas kemi shkuar në Shkodër, tek Motrat Saleziane. Aty kam takuar 'Bijat e dashurisë Hyjnore', të cilat vinin çdo ditë për t'i ndihmuar Motrat Saleziane që shërbimin e tyre ndaj kosovarëve: më ka mahnitur zemërgjerësia dhe mikpritja e njerëzve këtu në Shqipëri dhe më ka magjepsur jashtëzakonisht shumë përkushtimi, puna dhe shërbimi i Motrave. Kuptova se ishte vetë dora e Zotit që më kishte ruajtur dhe më

kishte udhëhequr. Në mua filloi të lëvizë diçka dhe i bëra pyetje vetes time: 'Çka dëshiron Zoti nga unë?'. Disa ditë më vonë ndjeva një dëshirë të madhe për t'iu kushtuar Zotit në jetën rregulltare, gjë që e bëra pas lufte me pëlqimin dhe bekimin e prindërve të mi”.

Tingujt dhe fjalët e këngës “O e ambla Zoja e Shkodrës”, shkruar nga Atë Luigi Aluisi dhe kënduar përsëri nga bas-baritoni Lukë Mllugja, i dhanë fund aktivitetit të promovimit të librit “MIKPRITJA E NJË POPULLI QË KËRKON LIRI: 20-vjetori i angazhimit tonë ndaj refugjatëve nga Kosova”, në Shkodër.



VIZITA BARITORE NË DUKAGJIN 3-6 GUSHT 2019



facebook

HAPËSIRË MEDIATIKE

Regjistrohu në kanalin tone!
NgjarjetKishaKatolikeShkoderPult
Do të gësh video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës

Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaktor
Dom Gjovalin Sukaj

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqesja
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Fiorentina" Shkodër

